	KËRKESË PËR OFERTË		F-079
	Prishtinë	v. 1.0	Page 1 of 4

Kërkesë për ofertë

ZBATIMI I PROJEKTIT IDEOR PËR RISTRUKTURIMIN E OBORRIT TË KEC/SHKOLLA “MILENIUMI I TRETË”

Numri i referencës: KEC – MIL3 02/2024

1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Në kuadër të këtij projekti, planifikohet të kryhen punime të ndryshme që kanë për qëllim rristrukturimin e oborrit të shkollës “Mileniumi i Tretë” për të krijuar hapësirë të përshtatshme për nevojat e nxënësve, prindërve dhe stafit të shkollës.

Kërkesa për ofertë është e ndarë në tre LOTE, që mbulojnë veprime dhe punë të caktuara për zbatimin e këtij projekti. Më poshtë janë të renditura kërkesat dhe detajet për secilin LOT.

Numri i referencës: KEC – MIL3 02/2024


LOT1

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) fton kompanitë e interesuara të dërgojnë ofertat për punët në vijim.

Nr.	Përshkrimi	Hapësira
1	ZBATIMI I PROJEKTIT IDEOR PËR RISTRUKTURIMIN E OBORRIT TË KEC/SHKOLLA “MILENIUMI I TRETË” (sipas Projektit Ideor – Shtojca 1)	2,700 m ²

Punët dhe veprimet në kuadër të LOT1 përfshijnë:

- **Gërmimi dhe nivelizimi në sipërfaqen e tokës, si dhe mbushja e hapësirës së nivelizuar me rërë të trashë (zhavorr);**
- **Shtrimi i sipërfaqes me kubëza të betonit në oborr;**
- **Punime për krijimin e hapësirave (sipas Projektit Ideor – Shtojca 1):**
 - për parkim
 - për zbarkim të nxënësve
 - për vendosjen e shportave të mbeturinave si dhe
 - për shenjëzim vertikal dhe horizontal të gjithë hapësirës fizike në tokë

	KËRKESË PËR OFERTË		F-079
	Prishtinë	v. 1.0	Page 2 of 4

**Numri i referencës: KEC – MIL3 02/2024
LOT2**

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) fton kompanitë e interesuara të dërgojnë ofertat për punët në vijim.

Nr.	Përshkrimi
1	FURNIZIM DHE MONTIM I DERËS SË HYRJES , TRUPAVE NDRIÇUES ELEKTRIK DHE KIOSKËS SË OBORRIT TË KEC/SHKOLLA “MILENIUMI I TRETË” (sipas Projektit Ideor – Shtojca 1)

Punët dhe veprimet në kuadër të LOT2 përfshijnë:

- **Furnizim dhe montim i derës së hyrjes së oborrit (1 copë)**
 - Hapja e shtegut në rrethojën ekzistuese, furnizim dhe montim me derë lëvizëse të metalit të qëndrueshëm dhe të sigurt.
 - Zhvendosja e derës ekzistuese
- **Furnizim dhe montim i Kioskës (1 copë)**
 - Largimi i kioskës ekzistuese
 - Furnizimi dhe montimi i një kioske të re me madhësi 2 m nga 3 m
- **Furnizim dhe montim i trupave ndriçues elektrik (10 copë)**
 - Të pajisur me sensorë kohor për tu ndezur automatikisht në ambiente, të kenë gamë të gjerë dhe intensiv të ndriçimit, të përshtatshëm për ambientet e mëdha të oborrit dhe hyrjeve.


**Numri i referencës: KEC – MIL3 02/2024
LOT3**

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) fton kompanitë e interesuara të dërgojnë ofertat për punët në vijim.

Nr.	Përshkrimi
1	FURNIZIM DHE MONTIM I LAURAVE-RAMPAVE ELEKTRIKE TË OBORRIT TË KEC/SHKOLLA “MILENIUMI I TRETË” (sipas Projektit Ideor – Shtojca 1)

Punët dhe veprimet në kuadër të LOT3 përfshijnë:

- **Furnizim dhe montim të laurave / rampave elektrike (3 copë)**
 - Rampa elektrike të automatizuara dhe të menaxhueshme me teledirigjues nga distanca.


	KËRKESË PËR OFERTË		F-079
	Prishtinë	v. 1.0	Page 3 of 4

2. INFORMATA TË RËNDËSISHME PËR OFERTUESIT

- Plani Ideor (Shtojca 1):** Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) ka përgatitur një Plan Ideor (Shtojca 1) për ristrukturimin e oborrit të shkollës “Mileniumi i Tretë”. Secila ofertë duhet t’i përmbahet në përpikëri këtij Plani dhe duhet të bazohet në situacionin e lokacionit. KEC fton të gjithë ofertuesit që të caktojnë vizitë të lokacionit, për të kuptuar të gjitha detajet mbi lokacionin, shtrirjen e hapësirës ku do të zbatohet projekti, terrenin dhe modalitetet tjera, që mund të ndikojnë në zbatimin e projektit. Caktimi i kohës / orarit për vizitë në lokacionin ku do të zbatohet projekti, mund të bëhet përmes postës elektronike në procurement@kec-ks.org ose përmes numrit të telefonit +383 38 244 258 /lok. 127;
- Mbikëqyrja profesionale:** Oferta duhet të përmbajë informata rreth mbikëqyrjes profesionale të punimeve, duke filluar nga vlerësimi i lokacionit, përcaktimi i materialeve, përshtatshmëria e materialeve me nevojat specifike të shfrytëzuesve të hapësirave që do t’i nënshtrohen strukturimit (fëmijët/nxënësit, prindërit dhe stafi i shkollës), me theks të veçantë aspektit të sigurisë së fëmijëve.
- Cilësia e punimeve / materialeve:** Ofertuesit duhet të ofrojnë garancion për punët e kryera dhe për materialet e përdorura së paku 1 vit;
- Afatet kohore:** Oferta duhet të përmbajë afatet kohore për realizimin e projektit, që nuk duhet të jetë më shumë se 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

3. KUSHTET E OFERTIMIT

- Oferta duhet të përfshijë çmimin ku përfshihen të gjitha punët dhe shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj kërkesë;
- Oferta duhet të përfshijë kopjen e dokumentit të regjistrimit të biznesit dhe dokumentet e nevojshme për të mbështetur ofertën e tyre;
- Oferta duhet të ofrojë dëshmi dhe referenca për përvojën dhe punët paraprake të natyrës që mbulon kjo Kërkesë për Ofertë (KPO);
- Oferta duhet të jenë valide së paku 90 ditë pas datës së dërgimit;
- Ofertuesit mund të ofertojnë për një ose për të gjitha LOT-et;
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur, ku specifikohet referenca e Kërkesës për Ofertë (KPO) dhe numri i LOT-it;
- Zarfi dorëzohet në zyrat e KEC që gjenden në adresën: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”, Rr. “Qëndresa” Nr.48, Matëçan, 10000, Prishtinë, Kosovë.

	KËRKESË PËR OFERTË		F-079
	Prishtinë	v. 1.0	Page 4 of 4

4. KUSHTET E PËRGJITHSHME

- KEC mban të drejtën për ndryshime në specifikimet e përmbajtura në Kërkesën për Ofertë (KPO), për të cilat do të njoftohen të gjithë ofertuesit me shkrim;
- KEC rezervon të drejtën të kërkojë sqarime shtesë lidhur me ofertat;
- KEC e mban të drejtën të anuloj apo diskualifikoj ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar në rastin kur ofertat nuk i përmbahen kushteve të ofertimit;
- Ndërhyrja në këtë proces nuk është e lejuar dhe do të rezultojë në diskualifikimin e ofertës;
- Vendimi final, si rezultat i së cilës do të jetë kontrata, nuk do të bëhet përderisa nuk kompletohen të gjitha procedurat e brendshme të KEC;
- Ofertat do të vlerësohen nga Komisioni i Prokurimit i KEC në momentin e mbylljes së procesit;
- KEC nuk merr përgjegjësinë të kompensojë asnjë shpenzim që mund të bëhet nga kompanitë gjatë përgatitjes së ofertave;
- KEC do të bëjë transfer bankar në xhirollogarinë e punëkryesit në bazë të modaliteteve të specifikuara në kontratë. Pagesa në kesh nuk do të bëhen.
- Si rezultat i këtij tenderi mund të përzgjidhen një ose më shumë kompani për LOT-et e specifikuara në këtë ofertë.

5. KRITERET E VLERËSIMIT

1. Specifikimi i detajuar teknik duke përfshirë të gjitha kërkesat e specifikuara në Kërkesën për Ofertë (KPO) siç janë prezantimi i punës, planit, materialet etj.
2. Portfolio e kompanisë (përvoja, referencat).
3. Çmimi më i ulët.

6. DORËZIMI I OFERTAVE

Ofertat e mbyllura duhet të dorëzohen jo më vonë se me datën **06.05.2024, ora 15.00** në adresën:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”,
Rr. “Qëndresa” Nr.48, Matičan, 10000, Prishtinë, Kosovë

Çdo ofertë që dërgohet pas afatit të përcaktuar më lartë nuk do të merret parasysh.

Në qoftë se keni ndonjë pyetje, ju lutem kontaktoni Qendrën për Arsim të Kosovës, përmes postës elektronike në procurement@kec-ks.org.